



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Pradato Received/Delivery	24-07-2023	3	viti god Year
Organ / Njësia Org / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	5344/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.778/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktarianëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.778/2023 të datës 25.05.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Thesari i Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.778/2023 e datës 25.05.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, duke i njohur ankuesit të drejtën e shtesës tranzitore me listën e pagave të muajit gusht 2023 e tutje, si dhe kompensimin retroaktiv të shumës në emër të shtesës tranzitore për periudhën prill–korrik 2023.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje ankuesi) më datë 25.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4418/2023 të regjistruar nën shenjë A.nr.778/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos ekzekutimit të shtesës transitore nga Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në organin e punësimit/Komunën e Skenderajt, ndërsa kjo e fundit me datë 31.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokollit 4973/2023 të datës 25.05.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4413/2023 të datës 25.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 09.03.2023 nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Skenderajt me titull kërkesë për DMZP; E-maili i datës 30.03.2023 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Drejtorinë në Departamentin e Zyrtarëve Publik; E-maili i datës 31.03.2023 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Menaxheren e Personelit; E-maili i datës 03.04.2023 nga ankuesi për Drejtorin e Thesarit ; E-maili zyrtar i datës 04.04.2023 nga ankuesi për Ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimi me nr.11/2023 i datës 04.04.2023 për lirim nga detyra i të ankuesit i lëshuar nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të MFPT; Akt emërimi i datës 02.07.2018 i ankuesit; Akt emërimi me nr.02-112/01-0018623/23 i datës 06.04.2023 i ankuesit; E-maili i datës 07.04.2023 nga Drejtori i Thesarit për ankuesin; Opinion ligjor me nr.reference 88/2023 i datës 07.04.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme për Drejtorin Menaxhues të AKP-së; Ankesë me nr.3450 të datës 08.05.2023 nga ankuesi për U.d. i Drejtorit të Departamentit të Departamentit të Thesarit; E-maili i datës 25.05.2023 nga Drejtori i Thesarit për ankuesin; E-maili i datës 11.05.2023 nga zv.Drejtori i Thesarit për u.d.Drejtorin e Thesarit; E-maili zyrtar i datës 17.05.2023 nga ankuesi për U.d.Drejtorin e Thesarit; Kopja e letërnjoftimit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.05.2023 ; Përgjigje në ankesë e datës 31.05.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës dhe Kopja e konkursit e datës 25.01.2023 i shpallur nga Komuna e Skenderajt për pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasfereve në pozitën e punës Drejtorit i Auditimit të Brendshëm. Rrjedhimisht, ankuesi sipas shkresave të lëndës kishte aplikuar në Konkursin me numër reference RN00010827 për Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën e punës Drejtor i Auditimit të Brendshëm, i shpallur nga Komuna e Skenderaj më datë 25.01.2023.

Ankuesi pas përzgjedhjes si kandidat i suksesshëm, me datë 04.04.2023 parashtron kërkesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (*tutje MFPT*) për lirim nga detyra e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm, me ç'rast Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i organit përkatës të punësimit, me Vendimin Nr.11/2023 të datës 04.04.2023 aprovon kërkesën për lirimin e ankuesit nga detyra e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasfereve.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi pas pranimit në pozitën e Drejtor të Auditimit të Brendshëm, në Komunën e Skenderaj, në mënyrë të vazhdueshme kishte parashtruar kërkesë për pagës të shtesës tranzitore, mirëpo që një kërkesë e tillë nuk është ekzekutuar nga Thesari i Kosovës.

Kolegji i Këshillit, në vështrim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit analizoi bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit, gjegjësisht nenin 40 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik më të cilin përcaktohet se: 1. *Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.* 2. *Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3.*



Përfundimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore.

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, secilit nëpunës i garantohet shtesa tranzitore, nëse para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i njëjti ka realizuar pagë me të lartë se paga e përcaktuar me këtë ligj, në atë mënyrë që në vitin e parë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nëpunësi realizon shtesën tranzitore në vlerë prej 100%, në vitin e dytë më vlerë prej 50%, dhe nga viti tretë nëpunësi civil përfiton pagë sipas këtij ligji.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në provat materiale të çështjes është konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm në Komunën e Skenderajt ka filluar me shpalljen e konkursit për Lëvizje Brenda Kategorisë, me datë 25.01.2023, pra, para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe së e njëjta procedurë kishte përfunduar sipas kushteve të shpalljes së konkursit. Andaj, duke qenë se procedura përmes të cilës ankuesi është emëruar në pozitën e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm në Komunën e Skenderajt, kishte filluar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë parimin e sigurisë juridike të materializuar edhe me dispozitat e nenit 157 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vlerëson së me të drejtë procedura ka vijuar dhe përfunduar sipas dispozitave të ligjit që ka qenë i zbatueshëm më rastin e fillimit të procedurës përkatëse, dhe se ankuesit mbi këtë bazë i njihet e drejta e realizimit të pagës nën kushtet e përcaktuara në konkursin e datës 25.01.2023, përfshirë këtu edhe shtesën tranzitore siç përcaktohet me dispozitat e nenit 40 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Për më tepër, Kolegji si fakt relevant për vendosje meritore mori parasysh rrethanën së ankuesi ka ushtruar pozitë të njëjtë si Drejtor i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe së të njëjtën pozitë e ushtron edhe në Komunën e Skenderajt i përzgjedhur sipas procedurës së datës 25.01.2023 për lëvizje brenda kategorisë, andaj mbi këtë fakt dhe nisur nga konstatimet si me lart, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.778/2023

Sabile AVDYLI
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

